



18.03.2011

Drejtuar Kryetarit të bashkisë

Lenda : Ftesa për partneritet dhe pjesëmarrje në Ora e Tokës - Earth Hour WWF 2011

I nderuar zoti Kryetar,

Për gati 4 vjet, Earth Hour – WWF (Ora e Tokës) 2011 ka ndërtuar një veprimtari globale e cila është aktualisht një prej markave më të njohura të fushatave mjedisore në planet, që flet në 38 gjuhë të botës. Këtë vit eventi do të mbahet të shtunën 26 mars në orën 08:30 – 09:30 PM dhe do të kremtohet në të gjithë globin nga qindra miliona njerëz, në më shumë se 128 vende dhe rajone, dhe në mbi 4000 qytete. Earth Hour tejkalon racën, fenë, kombësinë, gjininë, politiken dhe brezat në një përpjekje për të mbrojtur dhe për të nderuar të vetmen gjë që ne të gjithë kemi të përbashkët – planetin Tokë.

WWF fton **Bashkinë Tuaj** për t'u bashkuar me këtë lëvizje globale dhe të partnerizohet me Earth Hour në gjetjen e mënyrave për të punuar, jetuar dhe për të bërë biznes të qëndrueshem në çdo orë. Në veçanti, ne ftojmë Bashkinë Tuaj që të bashkohet me ne për të **fikur apo të zbehë për një orë dritat e ndriçimit të jashtëm të ndërtesës së bashkisë tuaj dhe për rreth** gjatë kesaj ngjarjeje globale "pa drita" të Shtunën 26 mars duke filluar nga ora 08:30 pm. Ky aktivitet mund të dokumentohet me disa fotografi për tub ere ne vijim pjese e kolazhit boteror qe do te prodhohet per te ilustruar ngjarjen dhe evidentuar qytetin tuaj si pjesmarres. Ne do t'ju luteshim qe ju te gjenit gjithashtu rastin qe ti drejtoheshit qytetareve tuaj me nje mesazh ne kuader te aktivitetit te kesaj dite nepermjet medias lokale ose asaj kombetare. Me kete iniciative do te bashkohen edhe shume bashki dhe institucione te tjera te vendit

Earth Hour është bërë një lëvizje globale mjedisore, e themeluar tashme, që lejon vendet në mënyrë efektive të ofrojnë një fushatë publike nga një nivel lokal për t'u bërë pjesë e një veprimi me të gjerë global. Tani në vitin e saj të pestë, Earth Hour ka një mundësi unike për të ndërtuar shpresën, pasionin, vullnetin e mirë, dhe arsyen e një komuniteti global që e shohin logjikën e zhvendosjes së përpjekjeve tona drejt një të ardhme të qëndrueshme. Earth Hour është duke ndërtuar një lagje të ndërlidhur globale që mendon dhe sjell (ben) qëndrueshmërinë dhe ruajtjen çdo dite. Duke ndërtuar mbi një platformë të gjerë dixhitale, aleancave globale dhe rrjeteve sociale, Earth Hour frymëzon një bashkëpunim që drejton të menduarit inovativ në të gjithë planetin, në përfundimin e sigurimit të një platformë interaktive për krijimin dhe ndarjen me të tjeret të gjetjes së zgjidhjeve reale ndaj sfidave mjedisore botërore që janë globalisht të prekshme.

Earth Hour është duke zhvilluar, lëvizur përtej ngjarjes së përvitshme "pa drita" ngacmimin e emocioneve dhe angazhimin e njerëzve, komuniteteve, bizneseve dhe qeveritë e gjithë botës, që janë të frymëzuar të drejtojnë një revolucion globalë mjedisore. Ne po inkurajojmë sa më shumë njerëz,



kompani dhe organizata të jetë e mundur për ta çuar Earth Hour "Përtej Orës".

Me anë të partneriteteve me organizata si ANEP – SHOQATA PËR POLITIKA TE REJA MJEDISORE, BELLS Movement, Urban Research Institute e te tejtje, ne mund të krijojmë dhe të kremtojmë veprimtari të medha apo të vogla që tregojnë vizionin e Earth Hour per zgjidhjet reale për nje jetesë të qëndrueshme në çdo nivel, në çdo orë rreth botës.

Në veçanti, ekipet tona të organizimit në të gjithë Shqipërinë do të ishin të nderuar që të bashkëpunonin me Bashkine Tuaj, me një rrjet partnerësh të gatshëm për të bashkëpunuar në të gjitha iniciativat. Prapa Earth Hour, qëndrojnë me mijëra biznese, qindra media partnere dhe miliona njerëz të gatshëm për të na ndihmuar për të kremtuar arritjet qe ne mund të realizojmë duke punuar së bashku.

Ne pritje te pergjigjes tuaj,
I juaji sinqerisht

Andy Ridley

Executive Director & Co-Founder
Earth Hour Global
E: andy@earthhour.org
T: +61 415 865 992

Prof. As. Dr. Romeo Hanxhari

Kryetar i ANEP – Shoqata per Politika te Reja te Mjedisit
Shoqata Organizatore Zyrtare e Earth Hour Albania
E: romeo.hanxhari@gmail.com
T: +355.692074907

Edlir Vokopola

Official Partner of Earth Hour Albania
BELLS Country Coordinator
URI – Urban Research Institute
E: evokopola@uri.org.al
M: +355 (0) 692082941